



DREJTORATI PER PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Bazuar në nenin 4, neni 11 dhe neni 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Lipjanit Nr.15-350-32607 dt.30.07.2020 për vënie në shqyrtim publik të Projekt dokumentit Harta Zonale e Komunës së Lipjanit Nr.15-350-32607 dt.30.07.2020, Komuna e Lipjanit - Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjesdit shpallë:

NJOFTIM PËR SHQYRTIM PUBLIK Projekt dokumenti - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028

Komuna e Lipjanit fton qytetarët, sektorin publik dhe privat, ekspertët OJQ-të dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në procesin e Shqyrtimit Publik të Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK.

Shqyrtimi publik Projekt dokumenti - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK do të zhvillohet në periudhë prej 30 ditësh nga data 19 shtator 2020 deri më 19 tetor 2020, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në orën 14:00, në ndërtesën e Komunës së Lipjanit – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, rruga "Shqipëria" Nr.28 si dhe në web faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Kundërshtimet, komentet apo sygjërimet në Projekt dokumentin - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028 mund të paraqiten në formë të shkruar gjatë periudhës së shqyrtimit publik deri më 19 tetor dhe i adresohen Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjesdit përmes Qendrës për Shërbim të qytetarëve, Kati përdhësë, Sporteli Nr.2 dhe Nr.3, përmes postës ose në email: DPUMM.lipjan@rks-gov.net.

Materiali në kopje fizike dhe sqarimet nga stafi do të zhvillohen në Ndërtesën e Komunës së Lipjanit - Salla e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ndërsa Kundërshtimet, komentet apo sygjërimet mund të shkruhen në librin e prezentuar.

Prezantimet publike të Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028, do të mbahen sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, dhe si në vijim:

Zona urbane - Qyteti i Lipjanit :

- Zonat Urbane: "Qendra", "Zona Urbane Perëndimore -1 (ZUP-1) ", ZUP-2, ZUL-8, ZUL-9" të mërkurën 23.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit, në Lipjan.
- Zonat Urbane: Zona Urbane Lindore ZUL-4, ZUL-6, ZUL-7, të premten më 25.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit, në Lipjan
- Zonat Urbane: Zona Urbane Lindore ZUL-2, ZUL-3, ZUP-5, dhe ZUL-5 të hënë 28.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit,
- Zonat Urbane: Zona Urbane Lindore ZUL-4, ZUL-6, ZUL-7, të mërkurën më 30.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit, në Lipjan

Zonat rurale :

Zona perëndimore e Komunës

- Prezentimi do të mbahet në Magurë të hënë më 05.10.2020 me fillim në orën 11:00 në objektin e Qendrës Rinore në Magurë.

Zona lindore e Komunës

- Prezentimi do të mbahet në Gadime të enjte 08.10.2020 me fillim në orën 11:00 në Shkollën Fillore "Zenel Hajdini" në Gadime.

Takimi Publik i Ekipit Komunal për Planifikim do të mbahet pas periudhës së shqyrtimit publik të mërkurën me datë 28 tetor 2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në Lipjan.

Personat fizik dhe përfaqësuesit e personave juridik të cilët kanë paraqitur Kundërshtimet, komentet apo sygjërimet me shkrim gjatë periudhës së shqyrtimit publik mund të marrin pjesë në këtë Takimin publik, në të cilin do të trajtohen dhe informohen për çështjet e prezentuara.

Dokumentet e Prezentuara:

- Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028
- Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK .